



Në bazë të nenit 47, paragrafi (1), pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6 /16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21) dhe neni 184, paragrafi (7) të Ligjit të Shërbimeve Pagesore dhe të Sistemeve Pagesore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 90/22), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

V E N D I M

për përcaktimin e mënyrës, të formës dhe të afateteve të dorëzimit të të dhënave dhe/ose informacionit nga lista e shërbimeve më përfaqësuese

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përcaktohet mënyra, forma dhe afatet e dorëzimit të të dhënave dhe/ose informacionit nga lista e shërbimeve më përfaqësuese në lidhje me llogarinë pagesore (në tekstin e mëtejme: shërbimet më përfaqësuese), të përcaktuara me Vendimin për përcaktimin e listës së shërbimeve më përfaqësuese në lidhje me llogarinë pagesore dhe formën dhe përmbajtjen e dokumentit informativ në lidhje me kompensimet dhe raportin e kompensimeve dhe simbolet e tyre të përbashkëta "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 271/22), në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore).
2. Ky vendim vlen për të gjithë ofruesit e shërbimeve pagesore që mundësojnë hapjen, mirëmbajtjen dhe mbylljen e llogarive pagesore të konsumatorëve.

II. MËNYRA, FORMA DHE AFATET E DORËZIMIT DHE PUBLIKIMIT TË TË DHËNAVE DHE/OSE INFORMACIONIT

3. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të paraqesin të dhëna dhe/ose informacion mbi kompensimet për shërbimet më përfaqësuese dhe dokumentin informativ për kompensimet, në pajtueshmëri me shtojcën nr. 1 nga Vendimi për përcaktimin e listës së shërbimeve më përfaqësuese në lidhje me llogarinë pagesore dhe formën dhe përmbajtjen e dokumentit informativ për kompensimet dhe raportin për kompensimet dhe simbolet e tyre të përbashkëta ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 271/22), në Bankën Popullore të lidhur në mënyrë elektronike në pajtim me Vendimin për lidhje në sistemin informativ të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 116/14).
4. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të paraqesin të dhënat dhe/ose informacionin nga pika 3) e këtij vendimi jo më vonë se pesë ditë pune përpara datës së fillimit të zbatimit të tyre.
5. Me përjashtim të pikës 4) të këtij vendimi, ofruesi i shërbimit pagesor, të cilit i është dhënë leje për të ofruar shërbime pagesore për herë të parë, është i detyruar të paraqesë të dhënat dhe/ose informacionin nga pika 3) e këtij vendimi, më së voni pas

kalimit të gjashtë muajve, duke e llogaritur nga dita e parë e muajit në të cilin është lëshuar leja.

6. Ofruesit e shërbimeve pagesore duhet të dorëzojnë të dhënat dhe/ose informacionet e para nga pika 3) e këtij vendimi jo më vonë se data 20 gusht 2023.
7. Banka Popullore në faqen e saj të internetit do të publikojë të dhëna karahsuese për secilin ofrues të shërbimeve pagesore për llojin dhe shumën e kompensimeve të cilat llogariten dhe kompensohen nga ofruesit individual të shërbimeve pagesore, dhe atë për secilin prej shërbimeve që përcaktohen si më përfaqësuese të llogarisë së pagesës së konsumatorit, në ditën e zbatimit të tyre, me përjashtim të të dhënave nga pika 6) e këtij vendimi, të cilat do të publikohen më së voni deri më 30 shtator 2023.

III. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

8. Guvernatori i Bankës Popullore e përcakton mënyrën e dorëzimit të të dhënave dhe/ose informacioneve në Bankën Popullore për të krahasuar kompensimet e shërbimeve më përfaqësuese në lidhje me llogarinë pagesore. Udhëzimi nga paragrafi 1) i kësaj pike do të miratohet më së voni në afat prej një muaji nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
9. Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe do të fillojë të zbatohet nga 1 janari 2023.

V nr. 02-15/XX-2/2022
25 nëntor 2022
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска